REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

Nr. 8708 Prot.

Lushnje më, 14 / 09 /2026

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK

PËR PËRDORIMIN E FONDIT REZERVË MBI SHPËRBLIMIN E SPORTISTIT LAURENC HASKO DHE TRAJNERIT AMARILDO GJYLA

Të nderuar zoterinj këshilltarë!

Peshëngritja është një sporti i bazuar në forcën fizike të personit që e ushtron. Ushtrohet me ngritjen e peshave të rënda dhe e cila ndahet në kategori peshash edhe mbështetur edhe në moshat e sportistëve. Ky sport cilësohet edhe si një nga sportet më të vjetra në botë. Sportisti që ushtron sportin e peshëngritjes vlerësohet nga dy lëvizjet e tij ose të asaj që e ushtron, si: *rrëmbimi, pastrimi dhe hovi.*

Sporti i peshëngritjes është përfaqësuar zyrtarisht në Lojërat Olimpike moderne që nga fillimi në 1896 dhe në Sidnei në vitin 2000 u bë si sport përfshirës edhe pë gjininë femërore. Në Lushnje është hapur për herë të parë ekipi i peshëngritjes në vitin 1985 me sportistë të grupit U-14. Ndër vite ekipi i peshëngritjes ka arritur të marrë kupa të ndryshme si në rang kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar.

Pranë Bashkisë Lushnje ka ardhur kërkesa nga Federata Shqiptare e Peshëngritjes, për shpërblimin e sportistit së shpallur kampion në Kampionatin Kombëtar për të Rritur, Laurenc Hasko. Ai arriti rezutate të rëndësishme në kategroinë 65 kg në kategoritë: *stili i shkëputjes 105 kg, stili i shtytjes 125 kg dhe totali i dygarëshit 230 kg*, me trajner z. Amarildo Gjyla.

Fondi për shpërblimin e sportistes që ka fituar vendin e parë në Kampionatin Kombëtar për të Rritur, Laurenc Hasko. Ai arriti rezutate të rëndësishme në kategroinë 65 kg në kategoritë: arriti rezutate të rëndësishme në kategroinë 65 kg dhe medalje ari në kategoritë: *stili i shkëputjes 105 kg, stili i shtytjes 125 kg dhe totali i dygarëshit 230 kg*, është **100 000** ***(njëqind mijë)*** lekë, me trajner z. Amarildo Gjyla që do të shkojnë për shpërblimin e dhe në masën 40% të vlerës që përfiton sportisti **40 000** ***(dyzetë mijë)*** **lekë**.

Propozojmë miratimin e ketij projekt-vendimi.

Ju faleminderit!

KRYETAR I BASHKISË

ERISELDA SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – BASHKIA LUSHNJE

8708/1
14.09.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

PROJEKT-VENDIM

NR. 79 DATË 14/09/2026

PËR PËRDORIMIN E FONIDT REZERVË MBI SHPËRBLIMIN E SPORTISTIT LAURENC HASKO DHE TRAJNERIT TË TIJ AMARILDO GJYLA

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/____/2026, pasi analizoi relacionin e paraqitur nga Kryetarja e Bashkisë "**Mbi shpërblimin e sportistit Laurenc Hasko dhe trajnerit të tij Amarildo Gjyla"**, si dhe mbeshtetur ne ligjin nr. 139/2015 ***"Për vetëqeverisjen vendore"*** i ndryshuar, neni 54 germa "n" dhe V.K.M. Nr. 789 datë 15.12.2021 ***"Për kriteret, mënyrën e shpërblimint dhe trajtimin e sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre"*** në pikat 4 *(katër)*, 7 *(shtatë)* dhe 15 *(pesëmëdhjetë)*. Ju;

PROPOZOJMË:

1. Të miratoj përdorimin e fondit rezervë për shpërblimin me vlerë prej **100 000** ***(njëqind mijë)*** lekë për sportistin Laurenc Hasko dhe në masën 40% të vlerës që përfiton sportisti **40 000** ***(dyzetë mijë)*** lekë për trajnerin Amarildo Gjyla.
2. Në Aparatin e Bashkisë do të pakësohet Fondi Rezervë *(me kod 00-01-AF129-604-V491AAA)* në vlerën **140 000 lekë** dhe shtohen në Qëndrën e Kulturës dhe Klubi i Sportite, Programi ***"Disiplinat e ndryshme sportivve të mbështetura"*** *(me kod 00-01-AE129-602-V813AAB)* për **140 000 lekë.**
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Qendra Kulturore dhe Klubi Sportit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ***(dhjetë)*** ditë pas shpalljes.

Drejtor i Q.K.K.S.

Brizida Dervishi

Drejtor Juridik

Bedri Hida

KRYETAR I BASHKISË

Eriselda Sefa

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia.lushnje@yahoo.com